

Formular për SYLLABUS të Lëndës
NUDO-2 Viti -IV (Semestri: VII - VIII)
Prof. Majlinda Kelmendi

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Arteve Programi i studimit - Artet Vizuale (BA) pikturë, skulpturë, grafikë, ilustrim dhe vizatim.
Titulli i lëndës:	NUDO II
Niveli:	Bachelor (BA)
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti -IV (Semestri: VII - VIII)
Numri i orëve në javë:	3 orë Gr- I, 3 orë Gr -2
Vlera në kredi – ECTS:	Lënda NUDO II zhvillohet gjatë dy semestrave (VII dhe VIII) dhe ka gjithsej 4 ECTS , të ndara si më poshtë: Semestri VII: 2 ECTS Semestri VIII: 2 ECTS
Koha / lokacioni:	E martë gr I -14:00-16:15 E mërkurë gr II -14:00-16:15 A1/14 UP/FA/DAB (Ligjerata) 10/90 A1/07 UP/FA/DAB (Ushtrime laboratorike) 80/90 Fakulteti Arteve të Bukura, Universiteti Prishtinës
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Majlinda Kelmendi
Detajet kontaktuese:	Email: majlinda.kelmendi@uni-pr.edu Tel.: +383 44 146 036
Përshkrimi i lëndës	Lënda NUDO II synon të zhvillojë më tej aftësitë figurative të studentëve në vizatimin e trupit të njeriut, duke përqafuar qasje bashkëkohore, teknika të avancuara dhe eksperimentim stilistik. Ajo i pajis studentët me aftësi për të krijuar një portofol profesional, për të punuar në mënyrë të pavarur, dhe për të kontekstualizuar veprën e tyre në artin bashkëkohor përmes ideve konceptuale dhe filozofike, me referencë në pozime reale në shërbim të idesë, përfshirje të imagjinatës dhe shtresimit emocional në vepër. Fokus i veçantë i kushtohet reflektimit kritik , zhvillimit të portofolit profesional dhe ndërlihdjes së procesit krijues me estetikën bashkëkohore dhe filozofinë e artit si dhe dhe analizë të punës individuale dhe grupore.
Qëllimet e lëndës:	Thellimi i njohurive mbi formën, lëvizjen dhe ekspresionin përmes trupit. Zhvillimi i qasjeve bashkëkohore në vizatim. Aftësimi i studentëve për punë të pavarur dhe për prezantim profesional të portofolit. Inkurajimi i reflektimit mbi procesin artistik personal, në përputhje me kontekstin kulturor dhe estetik të kohës. Përgatitja për të qenë artistë aktivë në ekspozita, konkurse dhe skena bashkëkohore të artit.

Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Në përfundim të kursit, studenti duhet të jetë në gjendje të:</p> <p>Të shpjegojë raportet anatomike dhe shprehjet vizuale të trupit të njeriut në kontekst bashkëkohor.</p> <p>Të zbatojë teknika të avancuara dhe kreative në vizatimin e figurës njerëzore.</p> <p>Të analizojë kritikisht veprat e veta dhe të kolegëve përmes metodave të kritikës konstruktive.</p> <p>Të reflektojë mbi procesin e vet krijues dhe të vlerësojë rezultatet artistike në raport me konceptet estetike dhe bashkëkohore.</p> <p>Të krijojë një stil personal të qëndrueshëm dhe një qasje origjinale përmes eksperimentimit vizual dhe konceptual.</p> <p>Të dokumentojë dhe prezantojë në mënyrë profesionale punën e vet artistike në formë portofoli.</p>
---	--

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)

Aktiviteti	Orë / javë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata.	1	30/30 javë	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	30/30	60
Punë praktike	1	1/1	1
Kontaktet me mësuesin/konsultimet.	1	1/1	1
Ushtrime në terren	1	1/1	1
Kollokfiume, Seminare	2	2/2	2
Detyra të shtëpisë	1	1/1	1
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	1/1	1
Përgatitja përfundimtare për provim	1	1/1	1
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	1	1/1	1
Projektet,prezantimet, etj	1	1/1	1
Totali			100 orë

Në përputhje me Rregulloren e Universitetit të Prishtinës, **1 ECTS = 25 orë pune të studentit.**

Lënda **NUDO II** ka gjithsej **4 ECTS (2 ECTS për çdo semestër)**, që korrespondojnë me **100 orë punë totale** gjatë vitit akademik.

Shënime: Kollokfiume/Seminare (reflektime, prezantime)

<p>Metodologjia e mësimdhënies:</p>	<p>Kursi zhvillohet përmes një qasjeje të ndërthurur teorike dhe praktike, me qëllim që studentët të zhvillojnë aftësi të avancuara në vizatimin e figurës njerëzore dhe të përvetësojnë qasje bashkëkohore në trajtimin e trupit në art.</p> <p>Ligjëratat dhe demonstrimet përqendrohen në teknika dhe metoda bashkëkohore të vizatimit, ndërsa puna praktike në studio u mundëson studentëve të eksplorojnë interpretimin e nudos në mënyrë të pavarur dhe eksperimentale.</p> <p>Diskutimet dhe analizat në grup nxisin shkëmbimin e ideve, reflektimin kritik dhe vetëvlerësimin artistik, ndërsa udhëzimet individuale mbështesin zhvillimin personal dhe profesional të studentit.</p> <p>Studentëve u ofrohen ushtrime konceptuale dhe teknike (skica, ide dhe realizime) që ndihmojnë në përmirësimin e observimit, perceptimit të lëvizjes, formës dhe hapësirës.</p> <p>Kjo metodologji mbështet studentin në zhvillimin e shkathtësive teknike, estetike dhe konceptuale, duke ndërtuar një perspektivë origjinale dhe bashkëkohore artistike.</p> <p>Formatet e mësimdhënies:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ligjëratat interaktive dhe diskutime teorike • Demonstrime teknike në klasë dhe laborator • Punë praktike individuale dhe në grup në studio • Vizita në galeri dhe reflektime mbi përvojat vizuale • Udhëzime individuale dhe konsultime periodike me profesorin.
<p>Metodat e vlerësimit:</p>	<p>Vlerësimi në përputhje me rregulloren e UP-së ,për këtë kurs bazohet në një sistem pikësh që mat angazhimin, performancën dhe rezultatet e studentëve gjatë semestrit. Totali maksimal i pikëve është 100, të ndara si më poshtë:</p> <p>Komponentët e Vlerësimit:</p> <p>1 -Vlerësimi semestral VII – 25 pikë (përfshin projektet praktike dhe me shkrim).</p> <p>2 -Vlerësimi semestral VIII– 25 pikë (përfshin projektet praktike dhe me shkrim).</p> <p>3 -Pjesëmarrja aktive dhe vijimi i rregullt – 10 pikë Vlerësohet përmes pranishmërisë së rregullt në orë dhe angazhimit aktiv në diskutime.</p> <p>4. Provimi përfundimtar – 40 pikë Prezantimi i një projekti përmbledhës. Ky projekt vlerëson njohuritë dhe kreativitetin e studentit, projektet praktike të zhvilluara.</p> <p>Sistemi i Notimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 91% – 100% e pikëve totale: Nota 10 (shkëlqyeshëm) • 81% – 90% e pikëve totale: Nota 9 (shumë mirë) • 71% – 80% e pikëve totale: Nota 8 (mirë) • 61% – 70% e pikëve totale: Nota 7 (mjaftueshëm) • 51% – 60% e pikëve totale: Nota 6 (kalues) • < 51% e pikëve totale: Nota 5 (nuk kalon)

Literatura	
Literatura bazë:	<ul style="list-style-type: none"> • Călinescu, M. (2005). <i>Pesë fytyrat e modernitetit: Modernizmi, avangarda, dekadenca, kitsch-i, postmodernizmi</i> (përkth. G. Qëndro). Tiranë: Dituria. • Elkins, J. (2010). <i>Postmodern Perspectives on Life Drawing</i>. Chicago: University of Chicago Press. • Jones, A. (2012). <i>Seeing Differently: A History and Theory of Identification and the Visual Arts</i>. New York: Routledge. • O'Reilly, S. (2009). <i>The Body in Contemporary Art</i>. London: Thames & Hudson. <p>Burime të rekomanduara digjitale Studentët obligohen të përdorin materialet e ofruara nga Biblioteka Universitare e Universitetit të Prishtinës, përfshirë librat digjitalë, databazat akademike dhe platformat me qasje të hapur, të cilat përmbajnë literaturë teorike dhe vizuale relevante për lëndën.</p> <p>Burimet kryesore:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Biblioteka Universitare e Kosovës • Biblioteka Digjitale e Kosovës • Universiteti i Prishtinës – Biblioteka • Project Gutenberg – Open Access Library • Springer Open Access Books • DOAB – Directory of Open Access Books • Rudolph Muteswa – Artist Resources <p>Linqet:</p> <p>https://www.biblioteka-ks.org/# https://bibliotekadigjitale-ks.org/documents https://uni-pr.edu/page.aspx?id=1,137 https://www.gutenberg.org https://www.springer.com/gp/open-access/books https://doabooks.org https://rudolphmuteswa.com</p>
Literatura sheshtë:	<ul style="list-style-type: none"> • Jones, A., & Stephenson, A. (Eds.). (2001). <i>Performing the Body/Performing the Text</i>. London: Routledge. • Warr, T. (Ed.). (2000). <i>The Artist's Body</i>. London: Phaidon Press.

Semestri VII

Plani i dizejnuar i mësimi:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet ne Semestri VII
<i>Java e parë</i>	Prezantimi i lëndës, objektivave dhe metodologjisë. Diskutim mbi rëndësinë e nudos në artin bashkëkohor.
<i>Java e dytë</i>	Analizë e teknikave bashkëkohore në trajtimin e figurës. Diskutim kritik mbi ndikimet kulturore.
<i>Java e tretë</i>	Roli i emocioneve dhe perceptimit në krijim. Ushtrime praktike për shprehjen emocionale.
<i>Java e katërt</i>	Integrimi i teorisë dhe praktikës me media të përziera. Eksperimentim me qasje ndërdisiplinore.

<i>Java e pestë</i>	Prezantim i teknikave eksperimentale në vizatim. Punë praktike me materiale të ndryshme.
<i>Java e gjashtë</i>	Diskutim mbi materialet alternative dhe ndikimin e tyre. Ushtrime aplikative në artin figurativ.
<i>Java e shtatë</i>	Kritikë e qasjeve eksperimentale në artin bashkëkohor. Punë praktike me skica në atelie.
<i>Java e tetë</i>	Vizitë studimore në galeri arti. Reflektim dhe diskutim pas vizitës.
<i>Java e nëntë</i>	Analizë e koncepteve postmoderne në art. Ushtrime për trajtimin e trupit me ide filozofike.
<i>Java e dhjetë</i>	Fillimi i një projekti konceptual personal. Punë praktike dhe prezantim i ideve.
<i>Java e njëmbëdhjetë</i>	Punë praktike mbi trupin në kontekste të ndryshme.
<i>Java e dymbëdhjetë</i>	Diskutim mbi diversitetin kulturor në art. Ushtrime për përfaqësimin e trupit në mënyrë ndërkombëtare.
<i>Java e trembëdhjetë</i>	Praktikë për lëvizjen dhe kompozimin.
<i>Java e katërbëdhjetë</i>	Studim i detajeve të trupit (duar, këmbë, fytyrë). Shprehje ekspresive përmes fragmenteve.
<i>Java e pesëmbëdhjetë</i>	Diskutime dhe përgatitje për provim. Provimi i semestrit VII.

Semestri VIII –

Java	Ligjërata që do të zhvillohet ne Semestrin VIII
<i>Java e parë</i>	Eksplorim i mjeteve digjitale në vizatim. Analizë e mundësive që ato ofrojnë.
<i>Java e dytë</i>	Diskutim mbi ndikimin e teknologjisë në estetikë. Ushtrime praktike me skica.
<i>Java e tretë</i>	Rëndësia e bashkëpunimit në art. Fillimi i një projekti në grup.
<i>Java e katërt</i>	Planifikim dhe zhvillim i projektit bashkëpunues. Punë praktike me mbështetje nga profesori.
<i>Java e pestë</i>	Prezantim i projekteve bashkëpunuese. Reflektim mbi procesin e grupit.
<i>Java e gjashtë</i>	Diskutim mbi metodat e ndryshme në art. Ushtrime për diversitetin vizual dhe përfaqësimin.
<i>Java e shtatë</i>	Integrimi dhe ndërlidhja e mjeteve digjitale në vizatimin bashkëkohor. Punë praktike me eksperimente vizuale.
<i>Java e tetë</i>	Prezantime dhe ushtrime të përgatitura nga studentët.
<i>Java e nëntë</i>	Fillimi i projektit individual përfundimtar. Planifikim konceptual dhe teknik.
<i>Java e dhjetë</i>	Konsultime individuale. Zhvillim i projektit me mbështetje nga profesori.
<i>Java e njëmbëdhjetë</i>	Prezantim i projekteve individuale. Diskutim dhe kritikë në grup mbi punët.
<i>Java e dymbëdhjetë</i>	Ligjërata mbi raportet vizuale dhe teknike në vizatim. Ushtrime për dokumentim të procesit.
<i>Java e trembëdhjetë</i>	Dorëzim i dokumentacionit të punës semestrale. Reflektim final mbi procesin krijues.
<i>Java e katërbëdhjetë</i>	Diskutime dhe përgatitje për provim.
<i>Java e pesëmbëdhjetë</i>	Diskutime dhe përgatitje për provimin final. Vlerësim përfundimtar.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

- Studentët duhet të jenë të pranishëm në klasë të paktën 15 minuta përpara fillimit të orës, për t'u përgatitur për mësim.
- Përdorimi i telefonave celularë gjatë orës nuk lejohet; ata duhet të jenë të fikur ose në modalitet të heshtur.
- Kërkohet respektimi i qetësisë dhe i një ambienti akademik të përshtatshëm gjatë procesit mësimor.
- Orari i përcaktuar i përfundimit të mësimit duhet të respektohet me korrektësi.
- Mosrespektimi i orarit apo sjellja joetike gjatë procesit mësimor ndikon në notën përfundimtare dhe në vlerësimin e pjesëmarrjes aktive.

Përgatitur: Prof. Majlinda Kelmendi

Prishtinë, 2025